

Br/Nr. 404 / 23
Tuzi - Tuz, 03. 04. 2023. godine

Na osnovu člana 28 Statuta Društva sa ograničenom odgovornošću “Pijace/Tregu” Tuzi, Odbor direktora Društva na XVII sjednici održanoj dana 03.04.2023. godine, d o n i o j e

ODLUKU

I

USVAJA SE Izvještaj o realizaciji Programa obavljanja komunalnih djelatnosti Društva sa ograničenom odgovornošću “Pijace/Tregu” Tuzi za 2022. godinu.

II

Tekst Izvještaja iz stava 1 Odluke, čini sastavni dio ove Odluke.

III

Izvještaj iz stava 1 Odluke se dostavlja Sekretarijatu za ekonomski razvoj na dalji postupak.

IV

Ova Odluka stupa na snagu danom donošenja.

Broj: 404/23
Datum, 03.04.2023.

ODBOR DIREKTORA DRUŠTVA

PREDSJEDNIK

Demir Drešević



Dostaviti:

- Službi Predsjednika Opštine
- Sekretarijatu za ekonomski razvoj
- Arhiva Odbora direktora
- a/a

"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj 401/23

Tuzi, SA . 03 2023 god.



Pijace sh.p.k Tuz
d.o.o Tuzi **Tregu**

SHPK "PIJACE / TREGU" TUZ

R A P O R T I

*mbi realizimin e Programit mbi kryerjen e veprimtarive komunale
për vitin 2022*

Tuz, mars 2023

PËRMBAJTJA

I	Hyrje
II	Të dhënat themelore mbi ushtruesin e veprimtarive komunale ▪ Të dhënat themelore identifikuese ▪ Forma e organizimit ▪ Aktet themeluese ▪ Çështjet juridike - statusore ▪ Struktura e pronësore ▪ Organizimi i brendshëm dhe skema organizative ▪ Veprimtaritë themelore dhe detyrësore të ushtruesit të veprimtarive komunale ▪ Organet e udhëheqjes dhe drejtimit
III	Kapacitetet e ushtruesit të veprimtarive komunale ▪ Resurset njerëzore ▪ Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale ▪ Pajisjet dhe parku i makinave
IV	Bazat për përpilimin e Raportit
V	Raporti mbi realizimin e aktivitetit fizik
VI	Realizimi i planit financiar
VII	Politika e rrogave dhe punësimit
VIII	Borxhi
IX	Realizimi i planit të prokurimit publik
X	Politika e çmimeve
XI	Vërejtjet përfundimtare

I HYRJE

Procedura për aprovimin e raportit vjetor mbi realizimin e programit të veprimtarive komunale është paraparë me nenin 26 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 18/02, 66/19). Në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të nenit të lartpërmendur të Ligjit mbi veprimtaritë komunale, është paraparë që ushtruesi i veprimtarisë komunale është i obliguar që raportin vjetor mbi realizimin e programit me bilancin e gjendjes dhe suksesit t'ia dorëzojë organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes lokale më së voni deri më 31 mars të vitit aktual, për vitin paraprak, si dhe që Kuvendi i njësisë së vetëqeverisjes lokale të miratojë raportin vjetor nga paragrafi 3 i këtij neni, më së voni deri më 30 qershor të vitit aktual, për vitin paraprak.

Raporti vjetor mbi realizimin e programit për kryerjen e veprimtarive komunale (në tekstin e mëtejshëm: Raporti) të Shoqërisë për vitin 2022 është përgatitur në bazë të dispozitave të Rregullores mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20), e cila është sjellur në përputhje me Ligjin mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 18/02, 66/19).

Raporti jep të dhëna për veprimtarinë e Shoqërisë në vitin 2022, përmes të dhënave për Shoqërinë dhe aktivitetet e saj, kapacitetet e Shoqërisë, realizimin e aktivitetit fizikë dhe planit financiarë, çështjet që lidhen me politikën e pagave dhe punësimit, borxhin, zbatimin e planin e prokurimit publik, politikën e çmimeve dhe vlerësimin e situatës dhe rezultatet e arritura.

Veprimtaria komunale e mirëmbajtjes së tregjeve si dhe krejt veprimaria e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz në vitin 2022 është kryer në përputhje me rregulloret e mëposhtme:

Ligjet themelore

- Ligji mbi shoqëritë afariste ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 65/20, 146/21);
- Ligji mbi punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 08/21, 59/21, 68/21, 145/21);
- Ligji mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 34/22);
- Ligji mbi prokurimet publike ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19);
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 34/14, 44/18);
- Ligji mbi pagat e punonjësve të sektorit public ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 16/16, 83/16,

- 21/17, 42/17, 12/18, 39/18, 42/18, 34/19);
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/14, 06/14, 43/15, 70/17, 67/19, 146/21);
- Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 47/08, 04/11, 22/17);
- Ligji mbi pronën shtetërore ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 21/09, 40/11);
- Ligji për fiskalizimin në qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 46/19, 73/19, 08/21);
- Ligji për tregtinë e brendshme ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 49/08, 40/11, 38/19).

Rregulloret e vetëqeverisjes lokale të Tuzit

- Vendimi mbi rëndin komunal të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19);
- Vendimi mbi tregje ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19);
- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21);
- Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz mbi të cilin Kuvendi Komunal i Tuzit dha pelqimin nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21).

II TË DHËNAT THEMELORE MBI USHTRUESIN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

Në këtë pjesë të Raportit, do japim të dhëna dhe informacione themelore lidhur me SHPK "Pijace/Tregu" Tuz si ushtrues i veprimtarisë komunale të mirëmbajtjes së objekteve të tregut.

II/1 Të dhënat themelore identifikuese

Ushtruesi i veprimtarisë komunale është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. Numri amë i Shoqërisë është 03399109.

Themeluesi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz është Kuvendi i Komunës së Tuzit, numri amë 02628988 me seli në Tuz.

II/2 Forma e organizimit

Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.

II/3 Aktet themeluese

Aktet themeluse të Shoqërisë janë Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) dhe Statuti i SHPK “Pijace/Tregu” Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021, mbi të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit dha pelqimin me Vendim nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 46/21).

II/4 Çështjet juridike - statusore

Statusi juridik i Shoqërisë rregullohet me aktin themelues, d.m.th. me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) dhe Statut të SHPK “Pijace/Tregu” Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021.

II/5 Struktura pronësore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pijace/Tregu” Tuz është themelua nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe dhe si e tillë është në pronësi të Komunës së Tuzit.

II/6 Organizimi i brendshëm dhe skema organizative

Në pajtim me Rregulloren aktuale mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, format bazë të organizimit të Shoqërisë janë sektoret, dhe ato janë:

- Sektori për çështje teknike - operative dhe
- Sektori për çështje ekonomike - juridike.

Në kuadër të Sektorit për çështje tekniko - operative funksionon Shërbimi për çështjet e tregjeve dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive, i cili më tej është i ndarë në tri (3) reparte:

- reparti i mallrave të përzier
- reparti i tregut të gjelbër dhe
- reparti për mirëmbajtjen e objekteve sportive.

Sektori për çështje ekonomike dhe juridike përfshin Shërbimin për financa dhe Shërbimin për çështjet juridike dhe të përgjithshme.

II/7 Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit së veprimtarive komunale

Veprimtaritë kryesore dhe dytësore që Shoqëria kryen dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Statuti i Shoqërisë përcakton veprimtarinë bazë që kryen Shoqëria, e cila është me interes publik dhe është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste me kodin 8299:

- ndërton, mirëmban dhe menaxhon objektet e tregut;
- ruan higjienën e përgjithshme në zonën e tregut dhe objektet tjera në pronësi të komunës së Tuzit;
- kryen punë të tjera në interesin publik.

Krahas këtyre aktiviteteve, Shoqëria kryen edhe veprimtari që nuk kanë karakter të aktiviteteve me interes publik, përkatësisht:

- përgatit dhe zbaton programe në fushën e investimeve;
- investimi në ndërtimin e objekteve me investim të përbashkët me investitorë të tjerë;
- marrja me qira e pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme.

II/8 Organet e udhëheqjes dhe drejtimit

Shoqërinë e udhëheq Themeluesi në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë në bazë të Statutit të Shoqërisë, me ç'gjë sigurohet interesi publik.

Kuvendi i Komunës së Tuzit, si Themelues:

- miraton aktin e themelimit, ndryshimet dhe plotësimet e aktit të themelimit të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për Statutin e Shoqërisë;
- shqyrton raportin mbi punën dhe sjell Vendimin mbi shpërndarjen e profitit;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordi të drejtorëve;
- sjell vendimin mbi ndryshimin e formës, ristrukturimin dhe likuidimin vullnetar të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për ndryshimin e emërimit, veprimtarisë, selisë dhe kapitalit themelor të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për çmimet e shërbimeve, të cilën e përcakton Bordi i drejtorëve;
- kryen veprime të tjera në pajtim me ligjin, Vendimin mbi themelimin dhe Statutin.

Organe e Shoqërisë janë Bordi i drejtorëve si organ i drejtimit dhe Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes i Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve:

- drejton Shoqërinë dhe jep udhëzime drejtorit ekzekutiv në aspektin e udhëheqjes së punëve të Shoqërisë;
- sjell Stautin e Shoqërisë, me pajtim të themeluesit;
- emëron drejtorin ekzekutiv;
- i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues;
- përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe sjell akte për zbatimin e saj në pajtim me udhëzimet e themeluesit;
- kryen mbikëqyrjen e udhëheqjes së Shoqërisë;
- sjell planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor mbi realizimin e planit vjetor të punës si dëshmisë financiare;
- përcakton çmimoren për kryerjen e shërbimeve të Shoqërisë, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
- sjell aktin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në pajtim me Kryetarin e Komunës;
- përcakton politikën e kontabilitetit të Shoqërisë dhe politikës së menaxhimit të rizikut;
- jep dhe shkarkon prokurën;
- miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv mbi veprimtarinë e Shoqërisë;
- sjell Rregulloren e procedurave mbi punën e Bordit të drejtorëve;
- kryen detyra tjera në pajtim me ligjin dhe Statusin e Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve përbëhet nga pesë (5) anëtarë, që janë përfaqësuesit e Themeluesit.

- Sa i përket punës së Bordit të drejtorëve, në vitin 2022 janë mbajtur gjithsej 12 seanca. Ndër të tjera, në senacat e Bordit të drejtorëve janë sjellur dhe miratuar aktet e nevojshme për funksionimin e Shoqërisë.

Drejtori ekzekutiv, si organ i udhëheqjes së Shoqërisë kryen këto detyra si në vijim:

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë;
- lidh kontrata në emër të Shoqërisë;
- organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë;
- menaxhon pasurinë e Shoqërisë;
- zbaton vendimet e Shoqërisë;
- vendos mbi dispozicionin e mjeteve financiare të Shoqërisë;
- propozon programe dhe plane në fushat për të cilat është themeluar Shoqëria;
- përgatit propozon e planit vjetor të punës dhe planin financiar të Shoqërisë;
- përgatit raportin vjetor mbi realizimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë si dhe dëshminë financiare;
- vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtim me ligjin;
- kryen dhe detyra të tjera lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë, në pajtim me ligjin, me Vendimin mbi themelimin dhe me Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria është e obliguar që ta informojë vazdhimisht Themeluesin dhe subjektet tjera që shprehin interes ligjor për përcjelljen e punës dhe funksionimin e saj.

III KAPACITETET E USHTRUESIT TË VEPRIMTARISË KOMUNALE

III/1 Resurset njerëzore

Në periudhën raportuese, Shoqëria kishte të angazhuar gjithsej 38 të punësuar, për të kryer detyra nga veprimtaria e Shoqërisë.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 9 (nëntë) prej tyre janë marrë me marrëveshje nga dy ndërmarrje tjera (konkretisht nga shpk "Pijace i tržnice" Podgoricë -7 dhe shpk "Komunale/Komunale" Tuz - 2), në përputhje me rregulloret mbi punë.

III/2 Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Me qëllim të zbatimit të veprimtarisë komunale të Ushtruesit, veprimtarinë komunale, për të cilën është themeluar, ka kryer në objektet që vijojnë:

<u>Objektet</u>	<u>Adresa</u>
1. Tregu i gjelbër	Tuz p.n.
2. Tregu i mallrave të përzier	Tuz p.n.

Tregu i mallrave të përzier ka në dispozicion 348 hapësira afariste - të tregut dhe 50 lokacione.

Tregu i gjelbër ka në dispozicion 25 vende të shitjes, një sektor për djathë dhe mish, 6 vende të shitjes për peshk. Në kuadër të tregut të gjelbër ekziston edhe lokali afarist, të cilin Shoqëria e jep në qira.

III/3 Pajisjet dhe parku i makinave

Shoqëria ende nuk ka pajisje të përcaktuara, përveç pajisjeve që gjenden në tregje, si dhe as veturë zyrtare.

IV BAZAT PËR PËRPILIMIN E RAPORTIT

Përpilimi i këtij Raportit bazohet në Rregulloren mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20) si dhe në bazë të paraqitjes së operacioneve financiare (që përfshin paraqitjen e krahasimit në raport me të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara.

V RAPORTI MBI REALIZIMIN E AKTIVITETIT FIZIK

Kjo Shoqëri, siç dihet menaxhon me dy tregje në Tuz - me tregun e mallrave të përzier dhe me tregun e gjelbër.

Tregu i mallrave të përzier në Tuz posedon 348 hapësira afariste - të tregut dhe 50 lokacione.

Në këtë periudhë raportuese, u përdor mbi 90% e kapacitetit të këtij tregut. Në vitin 2022, një total prej 393,274.27 EUR u gjenerua nga Tregu i mallrave të përzier. Në bazë të pagesave ditore, të ardhurat ishin 71,603.42 euro, ndërsa 321,670.85 euro u fituan në bazë të kontratave mbi qira.

Tregu i gjelbër posedon 25 vende të shitjes, një sektor për djathë dhe mish, 6 vende të shitjes për peshk. Në kuadër të tregut të gjelbër ekziston edhe lokali afarist, të cilin Shoqëria e jep në qira.

Në këtë periudhë raportuese, u përdor mbi 95% e kapacitetit në këtë treg.

Në vitin 2022, një total prej 14,000 EUR u gjenerua nga Tregu i gjelbër. Të gjitha të ardhurat në Tregun e gjelbër janë realizuar në bazë të kontratave mbi qira. Këtë vit nuk kishte tezga të përdorura në bazë të pagesave ditore.

VI REALIZIMI I PLANIT FINANCIAR

Në periudhën raportuese nga 01.01- 31.12.2022, SHPK "Pijace/Tregu" Tuz arriti një rezultat financiar, të cilin do ta paraqesim në mënyrë tabelare si dhe me pikëpamje krahasuese për të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara.

VII/1 Paraqitja tabelare e realizimit të planit financiar

Grupi i faurave, faturat	POZICIONI	Nr. i ren	Vërejtje, numër	Shuma	Shuma
--------------------------	-----------	-----------	-----------------	-------	-------

		ditj es		PLANI për vitin 2022	Realizimi i planit për vitin 2022
1	2	3	4	6	
60 i 61	1. Të ardhurat nga shitja – të ardhurat neto	201		70.500	71.603,42
630 i 631	2. Ndryshimi i vlerës së rezervave të prodjimeve të gatshme dhe prodhimitarisë së përfunduar	202			
62	3. Të ardhurat nga aktivimi i efekteve dhe mallit	203			
	4. Të ardhurat tjera nga veprimtaria (205 deri 207)	204		435.000	435.670,85
64 65	a) Të ardhurat tjera nga veprimtaria e rregullt	205		435.000	435.670,85
67, 691 i 692	b) Të ardhurat tjera nga veprimtaria e rregullr	206			
68, përpos 683,685	c) Të ardhurat në bazë të nivelimit të vlerës së pronës	207			
	5. Shpenzimet afariste (209+210)	208		149.148	142.460,10
50 i 51	a) Vlëra blerëse e mallit të shitur dhe shpenzimet e materialit	209		69.102	68.907,59
53, 54 i 55	b) Shpenzimet tjera nga veprimtaria (amortizimi, rezervimet dhe të dalat tjera afariste)	210		80.046	73.552,51
	6. Shpenzimet e rrogave, pagimi i rrogave dhe të dalat tjera personale (212+213+216+217)	211		312.000	319.595,65
52 (një pjesë)	a) Shpenzimet neto të rrogave, pagimi i rrogës dhe të dalat personale	212		234.500	239.775,25
	b) Shpenzimet e tatimeve dhe kontributeve (214 - 215)	213		66.400	68.720,40
52 (një pjesë)	1/ Shpenzimet e tatimeve	214		31.900	32.532,15
52 (një pjesë)	2/ Shpenzimet e kontributeve	215		34.500	36.188,25
52 (një pjesë)	c) Shpenzimet në bazë të pagesës së kontratave për punë	216		4.800	4.800
52 (një pjesë)	d) Kompensimet anëtarëve të organit drejtues	217		6.300	6.300
	7. Daljet në bazë të nivelimit të vlerës së pasurisë (përpos asaj financiare) (218+219)	218			
580, 581, 582, 589 (një pjesë)	a) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mallit (përpos atij financiar)	219			
584, 589 (një pjesë)	b) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mallit qarkullues (përpos atij financiar)	220			
57, 591 i 592	8. Të dalat tjera afariste	221			
	1. Rezultati afarist (201+202+203+204-208-211-217-220)	222			
	9. Të ardhura në bazë të pjesëmarrjes në kapital (223 - 225)	223			
660 (një pjesë)	a) Të ardhura në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personare të varur juridikë	224			
661 (një pjesë)	b) Të ardhura në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personave tjerë juridikë të lidhur	225			
669 (një pjesë)	c) Të ardhura në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personave juridikë të palidhur	226			
	10. Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare (interesi, ndryshimet e kursit dhe efektet e mbrojtjes së kontraktuar) (227 deri 229)	227			
660 (dio)	a) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare prej personave juridikë amë dhe të varur	228			

661 (dio)	b) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare prej personave tjerë juridikë të lidhur	229			
662 (një pjesë), 663 (një pjesë), 664 (një pjesë), 669 (një pjesë)	c) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare nga persona juridikë të palidhur	230			
	11. Të ardhurat tjera në bazë të interesit, ndryshimeve të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar (231 deri 233)	231			
660 (një pjesë)	a) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga perosni juridik amë dhe personave juridikë të varur	232			
661 (një pjesë)	b) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga perona tjerë juridikë të lidhur	233			
662 (një pjesë), 663 (një pjesë), 664 (një pjesë), 669 (një pjesë)	c) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga persona tjerë juridikë të palidhur	234			
	12. Nivelimi i vlerës së mjeteve afatshkurtra financiare dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë së qarkullueshme (235-236)	235			
683, 685	a) Të hyrat në bazë të nivelimit të vlerës së mjeteve aratshkurtra financiare dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë së qarkullueshme	236			
583, 585	b) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mjeteve aratshkurtra financiare dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë së qarkullueshme	237			
	13. Të dalat në bazë të interesit (kamatës), ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar (238 deri 240)	238			
560	a) Të dalat në bazë të interesit, ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit me personin juridik amë dhe persona tjerë të varur juridikë	239			
561	b) Të dalat në bazë të interesit (kamatës), ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit me persona tjerë të lidhur	240			
562, 563, 564, 569	c) Të dalat në bazë të interesit (kamatës), ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit me persona tjerë të palidhur	241			
	II. Rezultati financiar (222+226+230+234-237)	242			
	III. Rezultati i afarizmit të rregullt para tatimit (221+241)	243		44.352	45.218,52
690 – 590	IV. Neto rezultati i afarizmit që është zbritur	244			
	V. Rezultati para tatimit (242+243)	245		44.352	45.218,52
	14. Të dalat tatimore të periudhave (246+247)	246			
721	1. Tatimi aktual në fitim	247			
722	2. Të dalat apo të hyrat tatimore të prolonguara	248			
723	3. Obligimet tjera mbi TVSH-në	249		49.161	51.896,24
	15. Fitimi apo humbja pas tatimit (244-245)	250		-4.809	-6.677,72

	VI. BRUTO REZULTATI I POZICIONEVE TJERA TË REZULTATIT/ TË LIDHURA ME KAPITALIN (250 deri 257)	251			
330	1. Ndryshimi i rezervave të valorizuara në bazë të patundshmërisë, makinerive, pajisjeve, investimeve jomateriale dhe mjeteve biologjike	252			
331	2. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të parealizuar në bazë të përlogaritjes së raporteve financiare të afarizmit të huaj	253			
332	3. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të parealizuar në bazë të investimeve në instrumentet pronësore të kapitalit	254			
333	4. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve aktuale në bazë të planeve të kompensimeve të definuara të fitimeve (ose humbjeve) aktuale lidhur me planet e definuara të kompensimeve për pensione	255			
334	5. Ndryshimi i pjesëmarrjes në rezultatin tjetër gjithëpërfshirës të shoqërisë së bashkëngjitur	256			
335	6. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të parealizuar në bazë të instrumentave të mbrojtjes së investimeve neto në afarizmin e jashtëm	257			
336	7. Ndryshimet e rezervuarave të rivalorizuara në bazë të hexhingut dhe rrjedhave të parave të thata	258			
337	8. Ndryshimet tjera të fitimeve dhe humbjeve të parealizuar	259			
	VII. TË DALATA OSE TË HYRAT E PROLONGUARA TATIMORE NË PERIUDHË LIDHUR ME POZICIONET TJERA TË REZULTATIT / TË LIDHURA ME KAPITALIN	260			
	VIII. NETO REZULTATI I POZICIONEVE TJERA TË REZULTATIT / TË LIDHURA ME KAPITALIN (249-258)	261			
	IX. REZULTATI GJITHPËRFSHIRËS NETO (248-259)	262		-4.809	-6.677,72
	X. FITIMI PËR AKSION	263			
	1. Fitimi bazë për aksion	264			
	2. Zbritjet e fitimit për aksion	265			
	XI. REZULTATI NETO QË U TAKON PRONARËVE TË PERSONIT JURIDIK AMË	266			
	XII. REZULTATI NETO QË U TAKON PJESËMARRJEVE QË NUK E SIGUROJNË KONTROLLIN	267			

VII/3 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në periudhën raportuese

Në periudhën raportuese, Shoqëria ka realizuar të hyra në shumën totale prej 507,274.27€.

Në pozicionin me numrin rëndor 1, grupi i llogarive 61 - të ardhurat nga shitja/neto, të ardhurat prej 71.603.42 € i përbëjnë:

- të ardhurat nga shitja e mallit dhe shërbimeve / ofrimi i shërbimeve të shpenzimit individual komunal, gjë që përbën veprimtarinë kryesore të kësaj shoqërie me interes publik (veprimtari

komunale). Konkretisht kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve prodhuesve bujqësorë në Tregun e gjelbër / pagesa ditore prej 235 €.

Ofrimi i shërbimeve në Tregun e mallrave të përzier / pagesa ditor;
-Të ardhurat e realizuara prej 71.603,42 €

Në pozicionin me numrin rëndor 4, të ardhurat tjera nga afarizmi i rregullt, grupet e llogarive 64 dhe 65 në shumën prej 435.670,85 € përbëjnë:

grupet e llogarive 64-prihodi nga donacionet nga Themeluesi (Komuna e Tuzit), të olanifikuara në shumën prej 50.000 € në fillim të vitit 2022 dhe 50.000 € të tjera në pjesën e dytë të vitit 2022, grupet e llogarive 65- të ardhurat nga qiraja me qiramarrësit sipas kontratave të nënshkruara si në Tregun e gjelbër, ashtu edhe në Tregun e mallrave të përzier është në shumën prej 335.670,85 €. Në tregun e gjelbër janë të planifikuara të ardhurat prej 15.600, ndërsa në tregun e mallrave të përzier shuma prej 319.400.

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022, janë planifikuar të dala në shumën prej 513.951,99 €.

Llogaritë e grupit 50 i 51 në shumën prej 68.907,59 € i përbëjnë:

- shpenzimet për materiale (të zyrave, materiali për higjienë, inventari i imët etj) në shumë prej 5.000 €,
- shpenzimet e karburantit dhe lubrikuesve në shumë prej 9.403,76 €,
- shpenzimet e energjisë elektrike në shumën prej 32.267,56 €.

Llogarinë e grupit 52 ë përbëjnë shpenzimet e rrogave bruto për të punësuarit si dhe kompensimet për anëtarët e organit drejtues të Shoqërisë në shumë prej 319.595,65 €.

Mjetet në vlerë prej 313,295,65€ janë shpenzuar për pagat bruto të punëtorëve në vitin 2022, ndërsa 6,300,00€ janë shpenzuar për kompensimet e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë.

Llogaritë e grupeve 53, 54 dhe 55 në vlerë 80,046 € përfshijnë:

- shpenzimet e qirasë në vlerë prej 17,200 €,
- kosto amortizimi në vitin 2022 nuk ka pasur,
- shpenzimet e mirëmbajtjes së higjienës (heqja e mbeturinave) në vlerë 15,174,28 €,
- shpenzimet e dezinfektimit, kontrollit të dëmtuesve dhe dezinfektimit në vlerë prej 724,79 €,
- shpenzimet për ujë në vlerë prej 1,131,90 €,
- kostot e shërbimeve bankare-transaksioni i pagesës dhe taksave 927,15 €,

- shpenzimet për korrigjimin e problemeve të furnizimit me energji elektrike në tregun e mallrave të përgjithshme në vlerë prej 6,000,00 €,
- shpenzimet e rikonstruksionit të objekteve të tregut (zyra dhe tualete në tregun e mallrave të përgjithshme) në vlerë prej 11,851,95 €.
- shpenzimet e reprezentacionit në vlerë 794,66 €,
- kosto të tjera jomateriale (shërbime konsulence, shërbime të kopjimit të dokumenteve etj.) në vlerë prej 19,702,78 €.

Llogaria e grupit 723, obligimet mbi TVSH-në në vlerë prej 51,896,24 €.

Së fundi, kur llogariten të hyrat dhe shpenzimet totale në periudhën raportuese, arrijmë në përfundimin se në fund të vitit Shoqëria kishte një bilanc negativ (-6,677.72).

VII POLITIKA E RROGAVE DHE PUNËSIMIT

Tabelat 1 dhe 2, të cilat vijnë në tekstin e Raportit, përcaktohen si përmbajtje e detyrueshme të Programit, në përputhje me pikën 9 të shtesës 2 të Rregullores (politika e pagave dhe punësimit) mbi përmbajtjen e letërave të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale.

Tabela 1. Struktura e punonjësve sipas formimit profesional, d.m.th. nivelit e kualifikimit të arsimit

LLOJI I PUNËS	Të punësuar në vitin 2022	VI, VII nivel ose më shumë	IV nivel	III nivel	I1 ose I2 nivel	PK
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	3	3				
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE	2	1	1			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	2	2				
PUNËT JURIDIKE	1	1				

VEPRIMTARIA THEMELORE	13	1	7	2	1	2
MIRËMBAJTJA	6				2	4
VEPRIMTARIA DYTËSORE	2		1		1	
PUNËT LOGJISTIKE	9			3	6	
<i>GJITHSEJTE - 38</i>	<i>38</i>	<i>8</i>	<i>9</i>	<i>5</i>	<i>10</i>	<i>6</i>

Tabela 2. Struktura e punonjësve sipas moshes

LLOJI I PUNËS	18 - 25	26 - 34	35 - 45	46 - 55	56 - 64	Mbi 65
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	3					
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE	1	1				
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	2					
PUNËT JURIDIKE	1					
VEPRIMTARIA THEMELORE	1	7	2	1	2	
MIRËMBAJTJA				2	4	

VEPRIMTARIA DYTËSORE		1		1		
PUNËT LOGJISTIKE			3	6		
GJITHSEJTE - 38	8	9	5	10	6	

- Numri total i të punësuarve tregon faktin se në këtë Shoqëri përqindja e pjesëmarrjes së pjesës administrative të punonjësve është 21%, që është më pak se mesatarja në nivel të shtetit që kalon mbi 25 %.

VIII BORXHI

Gjatë vitit 2022, Shoqëria nuk kishte borxh kredie.

IX REALIZIMI I PLANIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Sistemi i ri i ESJN mundëson transparencë më të madhe të prokurimeve publike, disponueshmëri më të madhe të informacionit për procedurat e zbatuara të prokurimit publik të të gjithë autoritetëve kontraktuese, e rrjedhimisht edhe për SHPK "Pijace/Tregu" Tuz.

Ofertat dorëzohen në mënyrë elektronike dhe nuk ka komunikim ndërmjet subjekteve që kryejnë aktivitete të prokurimit publik dhe ofertuesve potencial deri në ditën e hapjes së ofertave, të cilat tani janë hapur në mënyrë elektronike.

Plani i prokurimit publik i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz për vitin 2022, i cili është miratuar më 28 janar 2022 me Vendim të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë numër: 410/22.

Plani është ndryshuar dhe plotësuar 1 (një) herë, më 11 mars 2022, me Vendim të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë numër: 633/22, e gjitha në përputhje me Ligjin mbi prokurim publik.

Procedura të hapura Prokurim i thjeshtë (publikuar përmes ESJN) - 9,101,07 €

Procedura që u krye me sukses si një prokurim i thjeshtë i referohet si më poshtë prokurimi:

1. Karburanti - 9,101,07 €.

Numri rëndor	Plani 2022	Realizimi i Planit
1. Shërbimet	23.765,00 €	20.467,46 €
2. Punimet	17.895,90 €	17.895,90 €
3. Mallrat	41.080,00 €	35.062,08 €
GJITHSEJTË	82.740,00 €	73.425,44 €

Shkalla e realizimit të mjeteve të planifikuara për prokurim publik - 88.74%.

X POLITIKA E ÇMIMEVE

Çmimorja aktuale e shërbimeve të Shoqërisë është përcaktuar dhe miratuar me Vendimin e Bordit të drejtorëve të Shoqërisë nr. 16/21 prej më 21.12.2021, për të cilin Kuvendi I Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin nr. 02-030/21-15722 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21, prej më 30.12.2021).

Në bashkëpunim me Themeluesin, duhet të përcaktojmë mënyrën e veprimit në të ardhmen, në mënyrë që të mos rrezikojmë funksionet bazë të veprimtarisë, dhe njëkohësisht të mbrojmë interesin publik nëpërmjet kryerjes së vazhdueshme të veprimtarive komunale.

XI VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Në vitin 2022, si vitin e parë të veprimtarisë, kjo ndërmarrje kishte shumë sfida përpara. Megjithatë, me ndihmën e Komunës së Tuzit si Themeluesit e kësaj ndërmarrje, mund të thuhet se ato sfida në pjesën më të madhe janë tejkaluar me sukses.

Në periudhën e ardhshme, me ndihmën e Themeluesit dhe me angazhimin e plotë të kapaciteteve tona të personelit, do të punojmë në përmirësimin e kushteve të përdoruesve të shërbimeve tona, si dhe në promovimin e funksionimit të Shoqërisë.

Vitin e kaluar jemi përpjekur të përmbushim detyrimet ndaj personave të tjera në masën më të madhe të mundshme, si dhe të arrijmë nivelin më të lartë të mundshëm të pagesës për shërbimet nga qiramarrësit e hapësirave të tregut.

Në fund, duhet të konkludohet qartë se Shoqëria do të ndërmarrë hapat e nevojshëm në veprimtarinë e saj të mëtejshme, të cilat do të rezultojnë në një stabilitet më të madh në të ardhurat dhe veprimtarinë e kësaj ndërmarrje.

DREJTORI EKZEKUTIV

Ruzhdi Lluka

Dorëzuar:

- Shërbimit të Kryetarit të Komunës
- Sekretariatit për zhvillim ekonomik
- Arkivit të Bordit të drejtorëve
- a/a